

ADINGPOKS-1P

*Paralyerje me viskozitet të ulët dy-komponentëshe epokside pa tretës.
Prajmer për sisteme epokside I dedikuar për nënshtresa poroze.*

Fusha e aplikimit:

Si paralyerje-prajmer për të gjitha sistemet epokside, të cilat duhet të vendosen në nënshtresa me strukturë me porozitet të lartë. Gjithashtu mund të aplikohet edhe si impregnim të sipërfaqeve të betonit ose të sipërfaqeve me suva çimentoje. Si punim përfundimtar i dyshemesë mund në mënyrë finale të përpunohet edhe me mbushës kuarci e vendosur në shtresën e freskët të prajmerit.

Cilësi:

- Rrëshirë me viskozitet të ulët epoksid;
- Adezion I shkëlqyer për lloje të ndryshme të nënshtresave;
- Me penetrim, i cili përgjigjet për nënshtresa poroze;
- Rezistues ndaj ujit dhe I padepërtueshëm për ujin;
- Bakteriologjikisht rezistent;
- Rezistencë e mirë për acide të buta, tretje të kripërave dhe vajra minerale;
- Rezistent në naftë dhe derivate të naftës,
- Ekologjik, pa tretës;

Karakteristika teknike:

Lloji:	rrëshirë epokside me viskozitet të ulët
Dendësia (EN ISO 2811):	1,25 -1,35 gr/cm ³ Raport I
Përzierjes:	A : B = 4:1
Kohë e përpunimit gjatë T = 20-25o C (EN ISO 9514)	30–35 minuta

Përgatitje e nënshtresës:

Nënshtresa duhet të jetë e shëndoshë, e thatë, e pastër, pa yndyrëra dhe pa pluhur. Nënshtresa e betonit duhet të jetë e hidro-izoluar dhe e siguruar nga depërtimi I ujit, për të mos ndodh ndarje e paralyerjes, si pasojë e shtypjes negative të ujit.

Nënshtresë e re betoni

Betoni duhet të jetë I vjetër më së paku 28 ditë, me fortësi minimale me kod 25 MPa dhe të mos përmbajë lagështi më të madhe se 5,0%. Mbetjet e suvasë, damkat nga ngjyra nëse ka të tilla në nënshtresën, duhet të mënjanohen. Nëse në sipërfaqen ka lëng çimentoje, e njëjta duhet të mënjanohet në mënyrë mekanike. Më në fund, nga nënshtresa duhet të mënjanohet pluhuri me thithëse industriale.

Nënshtresë e vjetër betoni

Nënshtresë e shëndoshë dhe e pastër janë parakushte kryesore për arritje të adezionit të mirë. Njëlloj si në sipërfaqe të re të betonit, mënjanimi I lëngut të çimentos bëhet në mënyrë mekanike. Yndyrëra dhe pa-pastërti të penetruara duhet të mënjanohen me detergjente ose ndonjë preparat për atë dedikim. Të gjitha dëmtimet të nënshtresës duhet të sanohen me përdorimin e materialeve përkatëse nga paleta prodhuese e ADING.

Nënshtresë çeliku

Nënshtresa e çelikut duhet të pastrohet me rërë (pastrim me rërë) deri në shkallën e pastërtisë CA 2½.

Vendosje:

Komponentët A dhe B para se të përzihet mes vete, duhet të përzihen përbrenda. Materiali përgatitet me përzierje të komponentëve A dhe B, me ç'rast përzierja përzihet me mikser të ngadalshëm (300 deri 500 rotullime/min.) deri në homogjenizimin e plotë. Sasia e materialit që përzihet, duhet të jetë në pajtim me kohën e hapur (kohën në dispozicion) për punë me materialin. Nëse paraqitet nevojë për hollim të materialit para vetë aplikimit të materialit, ai mund të hollohet me max 5% Rastvoruvaç P.

Vendosja bëhet me vënie të barabartë të materialit në nënshtresën me furçë të fortë, me të cilën materiali vëhet duke e fërkuar në nënshtresën. Te nënshtresat poroze mund të paraqitet nevoja për prajmerim (paralyerje) të sërishëm. Temperatura e nënshtresës dhe temperatura ambientale gjatë vendosjes së materialit duhet të jetë në kufijtë prej 10o C deri 30o C, ndërsa lagështua relative e ajrit të jetë <70 %.

Shpenzimi

0,2-0,35 kg/m²

Pastrimi:

Veglat dhe pajisja pastrohet me Rastvoruvaç – P menjëherë pas përdorimit.

Paketimi:

Në sete prej (A + B komponentë) prej 5,0 kg
(A komp. – 4,0 kg dhe B komp.– 1,0kg)
Në sete prej (A + B komponentë) prej 19,0 kg
(A komp. – 15,2 kg dhe B komp.– 3,8 kg)

Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në hapësira të thata, në temperaturë prej 5°C deri 30°C e mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell. Afati i përdorimit 12 muaj.

Rrezik për jetën: Nevojitet që të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë, si dhe thithje e drejtpërdrejtë gjatë përzierjes së komponentëve A dhe B. Në rast të kontaktit incidental të prodhimit me lëkurën të mënjanohet me pëlthurë lehtë e lagur me Rastvoruvaç – P, e pas kësaj menjëherë të pastrohet me ujë dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nevojitet që të sigurohet ajrosje e hapësirave ku punohet me rrëshira ose tretës.

Zjarr: Nevojitet që të sigurohet ajrosje e hapësirave ku punohet me rrëshira ose tretës.

Pastrimi dhe vendosja në depo: Mbetjet e palidhura të Adingpoks – 1P, veglat dhe pajisjet pastrohen me Rastvoruvaç-P. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullatave lokale për atë lloj të mbetjeve.

Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes